



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranuar - Primijsno Meicana 09-09-2016

Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vendues
	02-013/1143		



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/2008 nenit 51, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, dhe Kontratës për investim të përbashkët në projekt nr.02-016/1240 të datës 16.09.2015 e lidhur në mes të Komunës së Vitisë dhe Fondacionit Kosovo – Luxembourg, Kryetari i Komunës së Vitisë bien këtë:

### V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 45.000,00 € NË EMËR TË BASHKËFINANCIMIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT

#### I

Me këtë vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë ndan mjete financiare në shumë prej 45.000,00 € ( katërdhjet e pesëmijë euro) në emër të bashkëfinancimit për realizimin e projektit të përbashkët të investimit në sektorët e aktiviteteve të gjenerimit të hyrave dhe arsimimit i cili do të implementohet nga komuniteti i fshatrave: Budrikë, Skifteraj dhe Radivojc.

#### II.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2016 nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim kategoria ekonomike kapitale, projekti Participim me donator – Kodi ekonomik transfer kapital për entitet publik.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi derdhen në llogari të Fondacionit Kosovo-Luxembourg.

#### III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e thesarit e Komunës së Vitisë.

#### IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

02. Nr. 013/  
Viti, më 09.09. 2016

KRYETARI KOMUNËS SË VITISË

Sokol Haliti

